

## Në shkollën tonë u organizua seminar dy ditorë për personelin arsimor

Written by Bekim Kasumi

Monday, 08 February 2016 18:06 - Last Updated Thursday, 03 March 2016 19:03

---



Ne shkollë u organizua seminar dy ditorë me temën: "Metodat dhe teknikat e notimit të bazuara në kriteriume". Seminari u mbajt më 04-05.02.2016 në lokalet e shkollës, ku e përcollën 31 arsimtarë.

Të gjithë pjesëmarrësit u pajisën me çertifikata dhe u vlerësuan me 16 pikë.

Së shpejti pritet të organizohet seminari i njëjtë edhe për grupin tjetër të arsimtarëve.

Vlenë të ceket se është viti i dytë me radhë që bëhet organizimi i mbajtjes së seminareve në shkollë. Shpresojmë se një praktikë e tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen, në mënyrë që secili arsimtar dhe bashkëpunëtor profesional të sigurojë numrin e mjaftueshëm të pikëve të nevojshme, të parapara me rregulloren për aftësimin profesional, për të ruajtur licencën e punës.

Në bazë të bisedave me pecjellësit e seminarit, u konstatua se ai ishte i suksesshëm në çdo pikëpamje.

# Në shkollën tonë u organizua seminar dy ditorë për personelin arsimor

Written by Bekim Kasumi

Monday, 08 February 2016 18:06 - Last Updated Thursday, 03 March 2016 19:03

---

